

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)
PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT
MBI LIGJIN “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”
DIALOG ME PËRFAQËSUES TË SEKTORIT PRIVAT

Tiranë, 10 mars 2025

Takimi u organizua në kuadrin e bashkëpunimit të Sekretariatit të KI me Zyrën Komisionerit IDP dhe FIAA, me fokus ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit të ri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

I. Hapja e takimit:

- Znj. Diana Leka (Angoni), Drejtore e Sekretariatit të KI

Znj. Leka, falenderoi pjesëmarrësit për prezencën duke uruar mirëseardhjen! Nënvizoi kontekstin e bashkëpunimit të Sekretariatit me Zyrën e Komisionerit të IDP dhe FIAA si pjesë e iniciativave për të lehtësuar ndërveprimin e komunitetit të biznesit me institucionet, në këtë rast me institucionin rregullator përgjegjës, Zyrën e Komisionerit, bashkëpunim i cili ka filluar që në 2022, në kuadrin e analizës për Konsultimin Publik në Shqipëri.

Znj. Leka evidentoi nivelin e lartë të përfaqësimit në takim me një pjesëmarrje të gjerë të kompanive shqiptare por edhe të huaja të cilat kanë një traditë të gjatë me njohjen e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar në fushën e GDPR, pasi kanë zbatuar praktikatat më të mira në këtë fushë edhe më përpara se ky legjislacion të adoptohet në Shqipëri, në përputhje me udhëzimet e kompanive mëmë ku ato bëjnë pjesë. Znj. Leka nënvizoi që takimi t'i shërbente edhe shkëmbimit të eksperiencave më të mira, që do të mundësonin zbatimin sa më të lehtë të ligjit në praktikë, pa ato ngërçet që zakonisht shoqërojnë zbatimin e ligjeve në Shqipëri.

Znj. Leka informoi të pranishmit se së shpejti, bëhen 10 vite nga ngritja e KI u ngrit në kuadër të bashkëpunimit midis BERZH(SECO sot) dhe Qeverisë Shqiptare me qëllim lehtësimin e dialogut publik dhe privat në kuadrin e përmirësimit të klimës së investimeve. Kjo iniciativë ka nxitur dialogun duke inkurajuar sektorin publik që ta konsiderojë sektorin privat si një partner të barabartë dhe sektorin privat të marrë më shumë përgjegjësi në përfaqësimin e interesave më të gjera dhe jo atyre të subjekteve individuale.

- Z. Besnik Dervishi, Komisioneri i IDP

Z. Dervishi, falenderoi bashkëorganizatorët KI dhe FIAA dhe shprehu kënaqësinë për kontributin që pjesëmarrësit kanë dhënë deri më sot gjatë përgatitjes së ligjit të ri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe për kontributin e pritshëm në përiudhën që vjen për përgatitjen e akteve në zbatim të ligjit.

Z. Dervishi informoi mbi kontekstin e përgatitjes së ligjit të ri 124/2014 pas një periudhe të gjerë konsultimi me grupet e interesit dhe me asistencën e vyer të ekspertëve të BE. Ligji përbën një zhvillim përpara në përafrimin e kuadrit rregullator në vend në lidhje me

mbrojtjen e të dhënave personale me standardet e BE duke sjellë disa risi thelbësore. Në vijim ai nënvizoi rëndësinë e ligjit të ri duke qenë se çështjet që lidhen me kontrollin apo përpunimin e të dhënave personale prekin të gjitha kompanitë apo institucionet.

Z. Dervishi në mënyrë të përmbledhur bëri një pasqyrë të risive të ligjit duke nënvizuar se: (i) ligji garanton standardet më të larta për mbrojtjen e të dhënave personale si një e drejtë themelore e njeriut dhe e mbrojtur nga neni 35 i Kushtetutës; (ii) zgjerohet dhe përmirësohet kategoria e të drejtave të individit në lidhje me të dhënat personale; (iii) forcohet e drejta për akses dhe për mos ju nënshtruar vendimeve autonatike; (iv) rregullohet e drejta për tu harruar; (v) për kontrolluesit dhe përpunuesit vendosen standarde më të larta për sigurinë e të dhënave.

Në lidhje me risitë e prezantuar më sipër Z. Dervishi nënvizoi se zbatimi i tij, kërkon një frymë të re bashkepunimi dhe qasjeje. Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe kuptimit të këtij ligji do të jenë sfidues, si për zyrën e Komisionerit të IDP ashtu edhe për subjektet. Komisioneri nënvizoi nevojën e partneritetit luajal dhe institucional midis palëve duke vendosur theksin tek roli i nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale (DPO) dhe angazhimin e zyrës që në vijim të përfundojnë edhe kurrikulën e trajnimit për DPO dhe krijimin e netëork të DPOve. Z. Dervishi informoi të pranishmit edhe për hartimin e draftit të metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative, e cila do të mund të aksesohet në faqen zyrtare të Komisionerit IDP, ku palët mund të konsultojnë dokuemntin dhe të japin komentet e tyre përpara miratimit përfundimtar. Si përfundim, Z. Dervishi nënvizoi rolin e biznesit dhe të këtyre tryezave për njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

- **Z. Balazs Revezs- Presidenti i FIAA dhe CEO i Vodafone Albania**

Në fjalën e tij Z. Revezs tha se rregullimi i çështjeve që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale nuk është asnjëherë i tepërt. Legjislacioni në EU dhe tashmë edhe në Shqipëri vendos standarde të larta mbi përdorimin e të dhënave sensitive të klientëve tanë, të cilat janë kritike për të gjithë duke parë rritjen eksponenciale të të dhënave personale të cilat përdoren çdo ditë.

Z. Revezs, nënvizoi rëndësinë që komuniteti i biznesit duhet të përgatitet në këtë rrugëtim të ri që vendos ligji për mbrojtjen e të dhënave personale duke sjellë si shembull edhe rastin e Vodafone Europe të cilit ju deshën të paktën 2 vite për t'u përgatitur për përputhmërinë e tyre me këtë legjislacion. Ky rrugëtim kërkon investime nga kompanitë në struktura, IT, ndryshime politikash dhe procedurash.

Në përfundim, Z.Revezs, solli edhe shembullin e kompanive të cilat janë pjesë e FIAA të cilat e kanë nisur këtë proces më herët duke qenë pjesë e kompanive ndërkombëtare dhe shprehu kenaqësinë për mundësinë për të ndarë eksperiencën dhe ekspertizën e tyre të akumuluar në funksion të përputhshmërisë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

II. **Prezantimi i ligjit 124/2024 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”**

Prezantimi u bë nga Znj. Sabina Lalaj, eksperte ligjore duke e vënë theksin tek konceptet kryesore të ligjit dhe përkufizimet e tyre në ligj, të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë edhe të kompanive ndërkombëtare pavarësisht se nuk operojnë në Shqipëri, kriteret dhe kushtet për përpunimin e të dhënave personale, mbrojtja e të dhënave në projektim dhe

zbatim, e drejta për tu harruar dhe vlerësimin e ndikimit për mbrojtjen e të dhënave personale etj. duke sqaruar detyrimet të cilat gjejnë zbatim menjëherë dhe të atyre që hyjnë në fuqi pas 2 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Në vijim Znj. Besa Velaj përfaqësuese e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, bëri një retrospektivë të miratimit dhe konsultimit të ligjit në website të IDP, prej të cilit u morën një sërë komentesh dhe një pjesë e të cilave u përfshinë në draftin përfundimtar. Në vijim u bë më dije se ky ligj jo vetëm ju nënshtroi konsultimit publik nga Ministria e Drejtësisë, por edhe një konsultimi *ex ante* me Komisionin European. Znj. Velaj, solli në vëmendje të pjesëmarrësve se Metodologjia për Llogaritjen e Sanksioneve Administrative i është referuar Udhëzuesit të Bordit European për Mbrojtjen e të Dhënave, duke revolucionarizuar edhe punën e Komisionerit të IDP, pasi vlerësimi i sjelljeve të sanksionueshme është shumë i detajuar dhe kërkon edhe rritjen e kapaciteteve të të gjitha palëve. Znj. Velaj konfirmoi që Metodologjia do të hidhet për konsultim publik dhe ftoi palët për të dhënë kontributin e tyre. Në vijim Znj. Velaj bëri të njohura disa aspekteve të Metodologjisë dhe të sanksioneve të zbatueshme, dhe mënyrës së llogaritjes së tyre sipas xhiros vjetore të kompanive.

III. Përmbledhje e diskutimeve dhe pyetjeve kryesore

Në këtë sesion pjesëmarrësit patën mundësi të bënin pyetje dhe të merrnin përgjigje nga Znj. Besa Velaj dhe pjesëmarrësit në panel.

- 1) Z. Zak Topuzi nga Shoqata Shqiptare e Turizmit: Parashtroi disa aspekte në lidhje me mënyrën e përpunimit të të dhënave të turistëve të huaj e cila bëhet sipas sistemeve të menaxhimit hotelier, por të dhënat e tyre aksesohen edhe nga shumë punonjës të hotelit si pjesë e proceseve të punës dhe shprehu shqetësimin nëse dërgimi i të dhënave të klientëve me e-mail në permbushje të detyrimeve ligjore tek Qendra e Emigracionit është rruga e duhur.
- 2) Z. Kristi Vako, avokat dhe partner në Oracle Solicitors: Parashtroi një grup pyetjesh teknike për Zyrën e Komisionerit të IDP në lidhje me ligjin:
 - Kur është i nevojshëm një nëpunës i mbrojtjes së të dhënave dhe kuptimi i organit publik?
 - A ekziston një afat kohor për nxjerrjen dhe ndryshimin e akteve nënligjore që të jenë në përputhje me ligjin e ri 124/2024?
 - A ekziston mundësia e marrjes së një opinioni paraprak ligjor nga ana e një kompanie për proceset e përpunimit të të dhënave? Nëse jo, a përbën shkak moscertifikimi, për nisjen e një hetimi nga Zyra e Komisionerit të IDP dhe për vendosjen e një sanksioni administrativ?
 - Në rastin e trajtimit të të dhënave personale në një vend të besueshëm (BE) a duhet të bëhet kjo detyrimisht nëpërmjet një Data Processing Agreement? Nëse të dhënat transferohen në një vend që nuk ka mbrojtje adekuate, a e një ligji shqiptar SCC apo ekzistojnë mekanizma të tjerë?
- 3) Znj. Jonida Lakuriqi përfaqësuese e Vodafone Albania: Nuk parashtroi një pyetje konkrete por bëri disa konsiderata mbi rëndësinë e ligjit dhe solli shembuj të praktikave të mira të zbatimit të këtij legjislacioni në Vodafone.

Përgjigje nga Znj. Besa Velaj:

- Sqaroi Z. Topuzi mbi definicionin e të dhënave personale përfshirë edhe numrin e kartës së kreditit. Në lidhje me sigurinë e programeve të menaxhimit hotelier, sqaroi se është përgjegjësia e hoteleve me cilësinë e kontrolluesit siguria e të dhënave dhe marrja e masave teknike dhe organizative për të të siguruar përputhshmëri. Si pjesë e masave organizative është edhe trajnimi stafit hotelier dhe sanitar për mënyrën si trajtohen këto të dhëna duke qenë të kujdesshëm në përhapjen e të dhënave. Në lidhje me dërgimin me email të listave të klientëve, sqaroi se përsa kohë kjo është në përmbushje të një detyrimi ligjor që rrjedh nga legjislacioni i emigracionit, është në përputhje edhe me ligjin 124/2024.
 - Sqaroi Z. Vako, se ligji ka lënë autonomi për kontrolluesit dhe përpunuesit për të vlerësuar nëse duhet të emërojnë një DPO. Ligji ka përcaktuar kriteret në nenin 33 dhe masat në nenin 22 të cilat duhet të merren në konsideratë nga kompanitë, si edhe me parimin e përgjegjshmërisë, duke i ftuar kompanitë ta interepretojnë ligjin në gërmë dhe në frymë. Në lidhje me afatin e akteve nëligjore sqaroi se është 3 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Në lidhje me moscertifikimin, u bë me dije se deri më dot nuk ka patur një rast të tillë dhe se nuk mund të jepet një përgjigje në këtë moment. Por u nënvizua se certifikimi sipas nenit 28 të ligjit tregon përputhshmëri me ligjin duke shërbyer si inkurajim për kompanitë për të shkuar drejt certifikimit. Në lidhje me transefrimin ndërkombëtar të të dhënave u bë me dije se një nga risitë e ligjit është njohja e SCC-ve/BSR-ve. Në lidhje me transeferimin e të dhënave në vendet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave duhet përmbushur kriteret ligjore dhe nevojitet një bazë evidence. Adequacy për Shqipërinë është një çështje me karakter më shumë politik sesa teknik. Komisioni Europian ka thënë që adequacy do të jepet njëkohësisht me anëtarësimin në BE.
- 4) Znj. Marilda Lena përfaqësuese e RFZ Bank. Parashtroi disa pyetje me karakter konkret:
- A duhet që të konsiderohet i vlefshëm miratimi dhe dhënia e pëlqimit për produkte online me një check-box apo do të konsiderohet i nënkuptuar në përputhje me një sërë nesh të ligjit?
 - Mbledhja e pëlqimit për publikimin e fotove për eventet masive? Si mbledhet pëlqimi, si dokumentohet dhe si mbahet?
 - A mund të kemi një udhëzim nga IDP me case study për raste kur pëlqimi nuk është i vlefshëm?
- 5) Znj. Blerina Tushe përfaqësuese e BKT.
- Ku duhet të raportojë DPO brenda organizatës?
- 6) Znj. Bardhyl Baltëza përfaqësues i Shoqatës së Ricikluesve.
- A lejohemi të mbajmë tabelën e vlerësimit të punonjësve apo jo?
 - A duhet të lejohen institucionet të mbajnë ID e personave që futen në institucione?

- 7) Znj. Albana Laknori përfaqësuese e DHTIT. Nënvizoi rëndësinë e ligjit dhe miratimin e tij në kohën e duhur kur Shqipëria kërkon të bëhet pjesë e BE dhe kur të dhënat personale nuk trajtohen me seriozitet në Shqipëri. Znj. Laknori kërkoj që për aktet nëligjore në vijim të bëhet informim i gjerë i biznesit për të rritur ndërgjegjësimin e tij në mediat e shkruara edhe vizive. Shprehu gatishmërinë e DHTIT për të bërë trajnime periodike në vijim për biznesin.

Përgjigje nga Znj. Besa Velaj:

- Sqaroi Znj. Lena se kriteret për dhënien e pëlqimit janë të detajuara në nenin 8 të ligjit. Marrja e miratimit në mënyrë digjitale/online të pëlqimit është i vlefshëm me kushtin që të jetë i informuar. Duhet 2 check-box- pëlqej apo nuk pëlqej. Në lidhje me dokumentimin e pëlqimit, subjektet kanë autonomi për mjetet si mund ta marrin këtë pëlqim sipas kushteve dhe kriterëve të ligjit. Mund të kërkohej pëlqimi që në emailin ftesë, ku konfirmohet pjesëmarrja dhe pëlqimet në lidhje me aspekte të tjera. Sa i takon udhëzuesit, u sqarua se një udhëzues vetëm për pëlqimin është jo i mundur sepse fusha është shumë dinamike.
 - Sqaroi Znj. Tushe se vendi ku raporton DPO apo pozicioni i tij përcaktohet nga vetë kompania në përputhje me disa parime të tjera që lidhen me qeverisjen e mirë dhe autonominë e kompanive tregtare, për të siguruar pavarësi funksionit të DPO.
 - Në lidhje me çështjet e ngritura nga Z. Baltëza, u sqarua se pikërisht roli i DPO brenda kompanive është pikërisht për të këshilluar për situata të tilla dhe praktikatat që ndiqen brenda ndërmarrjeve. Regjistri i hyrjeve dhe daljeve nuk zbatohet nga IDP. Prezumimi është që dhe autoriteti publik duhet të marrë masat e veta në lidhje me administrimin, kontrollimin dhe përpunimin e të dhënave personale.
 - Në lidhje me vështjet e ngritura nga Znj. Laknori, u sqarua se thirrjet e pakëtruara do të trajtohen nga ligji i ri, projekti i të cilit është ende në proces. Në vijim u sqarua se vetë individët duhet të jenë të përgjegjshëm për autorizimin e përdorimit të të dhënave personale.
- 8) Znj. Evis Karandrea nga Assist Digital. Parashtrroi nevojën që ligji të zbatohet nga të gjitha kompanitë shqiptare duke sjellë në vëmendje se zbatimi sjell edhe një kosto vecanërisht për ndërmarrjet e vogla apo të mesme. Një temë e debatueshme në arenën ndërkombëtare është edhe arritja e avantazheve konkurruese nga moszbatimi i detyrimeve që lidhen me GDPR nga kompanitë e huaja ndërkombëtare kryesisht amerikane si Facebook, Google, Instagram apo ato europiane si Booking Trip Advisor, aplikacione bankare etc. Zbatimi në nivel evropian i GDPR duhet të sigurohet edhe për këta kolosë, të cilët zakonisht i kanë selitë në USA apo edhe Dublin. Në lidhje me sa më sipër pyetja e Znj. Karandrea ishte për të ditur më shumë mbi qasjen e Zyrës së Komisionerit IDP në lidhje me këto kompani të cilat mbledhin një numër të gjerë të të dhënave personale.

Përgjigje nga Znj. Sabina Lalaj:

Sqaroi se ligji i ri nga pikëpamja territoriale është i zbatueshëm dhe sjell detyrime edhe për kompanitë ndërkombëtare të cilat nuk kanë një seli në Shqipëri, por që kryejnë ose veprimtari tregtare me apo pa pagesë, ose të cilat monitorojnë sjelljen e individëve që jetojnë në Shqipëri. Këto kompani janë të detyruar tashmë të zbatojnë këtë ligj dhe të caktojnë një përfaqësues të tyre në Shqipëri për të dhënat personale.

Përgjigje nga Znj. Besa Velaj:

Sigurisht që deri më dje ka qenë e vështirë tu kërkoje llogari këtyre kolosëve, megjithatë me ligjin aktual dhe në zbatim të parimit të ekstraterritorialitetit të transpozuar nga direktiva, të gjitha këto kompani janë subjekte të ligjit 114/2024 për sa kohë përmbushin një nga 2 kriteret që u cilwsuan më lartë. Sfidë do të jete zbatimi edhe pse Bordi European ka miratuar udhëzues se si procedohet në këto raste.

9) Znj. Lindita Komani FIAA.

- A është ligji 124/2024 i zbatueshëm vetëm për kompoanitë private apo dhe për institucionet shtetërore? Në vijim u sollën si shembuj raste të daljes së të dhanave personale duke ju referuar QKB dhe e-Albania.

Përgjigje nga Znj. Besa Velaj:

Ligji përfshin në fushën e veprimi edhe autoritetet publike (administrata shtetërore dhe institucionet e pavaruara). Regjistri tregtar i QKB është regjistër i hapur deri në momentin që ju nuk e keni kundërshtuar. Individët kanë të drejtën të kërkojnë mospërpunimin e mëtejshëm të përpunimit. Në lidhje me hetimin e kryer për rastin e të dhënave të publikuara në vitin 2021 Znj. Velaj sqaroi se rezultatet e hetimit tashmë janë publikuar dhe mund të konsultohen në faqen zyrtare në internet të institucionit.

IV. Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Znj. Leka falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin dhe rëndësinë e diskutimeve. Takime të tilla në vijim do të jenë më të shpeshta duke konsideruar edhe proceset e integritetit dhe ecurinë e tij të shpejtë, të cilat kërkojnë një përfshirje më të gjerë të biznesit në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me BE, konsultimin, adoptimin dhe zbatimin e efektiv të tij në praktikë. Sekretariati modestisht ka kontribuar në këtë proces që në fazat e para të screening process përpara Komisionit European, dhe do të vazhdojë t'a bëjë këtë edhe në kontekstin e brendshëm.